

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë datë, 23.03.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, bazuar në nenin 23 të Rregullores nr. 04/2026 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025-2027, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Udhëzuesin për Aplikant si dhe nenin 12 të Rregullores nr. 04/20217 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve, nxjerrë:

V E N D I M

1. Për shpalljen e Thirrjes Publike për Mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave jo-qeveritare në fushën e Zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

I

1. Për implementimin e Thirrjes Publike do të zbatohën dispozitat e Rregullores MF - Nr. 04/2017 mbi Kruteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Mbështetje financiare publike për projektet /programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i MZHR-së, kodi i organizatës buxhetore 221 në kuadër kategorisë ekonomike Subvencionale dhe Transfere - kodi ekonomik 21200.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin 1 do të shpërndahën në bazë të Thirrjes Publike për Financimin e Projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1 Teksti i Thirrjes publike;
 - 1.2 Udhëzuesi për Aplikant;
 - 1.3 Formularët aplikimit ;
 - 1.4 Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve;
 - 1.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit.
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projekteve;
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit;
 - 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve dyfishta;
 - 2.4. Deklartata e Partneritetit (nëse është e aplikueshme);

2.6. Formulari për Deklaratën mbi aktivitetet e përshkruara të programit /projektit.

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve/ programeve të referuara nga paragrafi 1 të këtij neni janë:

- 3.1. Forma e Kontratës për financimin e programit apo projekti;
- 3.2. Formulari për përgaditjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
- 3.3. Formulari për përgaditjen e raportit financiar të programit apo projektit.

IV

1. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohën në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MZHR-së: mzhr.rks-gov.net.

V

- 1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat financiare publike për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikim, MZHR do të krijoj një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të thirrjes publike.
- 2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- 3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzuesin për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve.


VI

- 1. Pasi të merret Vendimi mbi aplikuesit e sukseshëm, projektet e të cilave i plotësojnë kushtet për financim, Udhëheqësi i institucionit do të nxjerr Vendim për ndarjen e mjeteve financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve.
- 2. MZHR do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të Kontratave.
- 3. Përgjegjësi për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal.

VII

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Refike Sülçevsi


UD Sekretare e Përgjithshme në MZHR

Vendimi i'u dërgohet;

- Kabinetit të Ministrit të MZHR-së;
- Departamentit për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Arkivit të MZHR-së.